



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 dhe 40 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, si dhe nenit 19 par. 19.4 pika d) dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i dates 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë, 30.11. 2023, miratoi këtë:

VENDIM
PËR MIRATIMIN E PLANIT ORIENTUES TË PUNËS SË KUVENDIT TË
KOMUNËS SË LIPJANIT PËR VITIN 2024

Neni 1

MIRATOHET Plani orientues i punës i Kuvendit të Komunës për vitin 2024.

Neni 2

Kuvendi i Komunës së Lipjanit planifikon ti mbajë 12 mbledhje të rregullta dhe secilës mbledhje të rregullt i paraprin mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Neni 3

Mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës do të mbahen sipas periodës kohore me rendin e ditës sipas tabelës në vijim:

JANAR 2024	Informatë e Kryetarit mbi Planin e Punës së Ekzekutivit për vitin 2024
	Raporti i Kryetarit mbi gjendjen ekonomike financiare të Komunës për periudhën Korrik – Dhjetor 2023
	Miratimi i Planit Vjetor të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSb)
	Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
SHKURT 2024	Bartja (rialokimi) i buxhetit të pa shpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual
	Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
	Shqyrtimi i raportit monitorues për zbatimin e qëllimeve dhe objektivave nga PZHK, PU dhe PRR për vitin paraprak
	Informatë mbi përfundimin e gjysmëvjetorit të parë shkollor
MARS 2024	Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
	Shqyrtimi i Raportit final financiar të Komunës për vitin 2023
PRILL 2024	Shqyrtimi i informatës tremujore financiare të Komunës për periudhën Janar – Mars 2024
	Informatë mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimin e tyre
	Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
	Vizitë e Kuvendit për shkëmbim përvojash në institucionet jashtë vendit
Maj 2024	Informatë mbi Qarkoren e parë buxhetore të MF-se
	Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
	Informatë mbi punën e komiteteve funksionale
QERSHOR 2024	Miratimi i Kormizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027
	Rishikimi i Buxhetit të Komunës për vitin 2024
	Shqyrtimi i raportit (informatës) rreth aktiviteteve të KKSb-së
	Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
	Informatë mbi realizimin e Planit të Prokurimit
KORRIK 2024	Shqyrtimi i informatës financiare të Komunës për periudhën Mars – Qershor 2024
	Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për Komunën për vitin 2023
	Informatë mbi Raportin e Performancës
	Informatë mbi përfundimin e vitit shkollor
	Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
	Pritja e mërgimtarëve nga anëtarët e Kuvendit në Kuvendin e Komunës.
GUSHT 2024	Informatë mbi përfundimin e fushatës së korrje-shirjeve
	Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
	Informatë mbi Qarkoren e dytë buxhetore të MF-se
SHTATOR 2024	Shqyrtimi dhe miratimi i Buxhetit të Komunës për vitin 2025
	Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025
	Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor
	Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal

	Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për tatimin në pronë
	Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për taksa komunale
TETOR 2024	Shqyrtimi i raportit financiar të Komunës për periudhën Korrik – Shtator 2024
	Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
NËNTOR 2024	Informatë e Drejtoratit për Shëndetësi dhe përkujdesje sociale për ofrimin e shërbimeve primare shëndetësore
	Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
	Informatë e Drejtoratit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural mbi të mbjellurat
	Informatë nga Këshilli komunal kordinues në mbrojtje të viktimave të dhunës në baza gjinore
DHJETOR 2024	Informatë mbi Planin Vjetor të Prokurimit Publik 2025
	Shqyrtimi i propozim-vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
	Informatë mbi Planin Vjetor të Auditorit të Brendshëm 2025
	Shqyrtimi i raportit (informatës) rreth aktiviteteve të KKSB-së
	Informatë nga Drejtoria për Rini, Kulturë dhe Sport
	Informatë mbi funksionimin e këshillave lokale

Neni 4

4.1 Kuvendi i Komunës, për shqyrtimin e çështjeve nga kompetenca e vet, të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, dispozitave tjera ligjore, Statutin e Komunës dhe Rregulloren e punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit mban së paku dhjetë mbledhje të rregullta brenda vitit kalendarik.

4.2 Kuvendi i Komunës mund të mbajë edhe më shumë mbledhje të rregullta brenda vitit kalendarik.

4.3 Kuvendi i Komunës mund të mbajë edhe mbledhje të jashtëzakonshme, urgjente dhe solemne në rastet e caktuara me dispozitat e cekura ligjore.

Neni 5

Plani i mbledhjeve të Kuvendit, i përcaktuar si në nenin 3 të këtij Vendimi është orientues dhe do të mund të ketë ndryshime gjatë vitit.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës

15 Nr. 030/01-66260

Lipjan, më 30.11.2023

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

